



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E SHËNDETËSISË

# **Plani i Integruar i Ministrisë**

## **2010**

Dhjetor 2009

## Mesazhi i Ministrit



Programi katërvjecar i Qeverisë na ka ngarkuar me detyrën e reformimit rrënjësor të sistemit shëndetësor me qëllim rritjen e aksesit, gamës dhe cilësisë së shërbimeve shëndetësore si dhe garantimin e burimeve financiare.

Një shoqëri e shëndetshme dhe e mbrojtur nga risqet është një synim madhor. Në vitet e shkuara, qeveria ka rritur fondet për sistemin shëndetësor, kryesisht në rritjen e pagave, përmirësimin e furnizimeve me medikamente, kryerjen e investimeve në rrjetin e shërbimit parësor e spitalor si dhe në vaksinimin dhe parandalimin e sëmundjeve. Kjo ka përbërë fazën e parë bazë të domosdoshme të ndërhyrjes reformuese në sistemin e shëndetit publik.

Sigurimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i kujdesit shëndetësor për popullatën është objektivi i Ministrisë së Shëndetësisë, ku cilësia e kënaqëshme do të konsiderohet si një ndër indikatorët kryesorë që do të përcaktojnë nivelin e shërbimit .

Mbështetur në Strategjinë e Sistemit Shëndetësor, dhe në zbatim të programit të Qeverisë, Ministria e Shëndetësisë, në programin e saj, synon thellimin e reformës së nisur, duke marrë masat e nevojshme për përditësimin e kësaj strategjie, me synim modernizimin e sistemit dhe përshtatjen e tij me format organizative dhe standartet europiane, bazuar në modelet dhe përvojat më të suksesshme bashkëkohore, gjë e cila do të ndikojë drejtpërdrejtë në përmirësimin e shëndetit për gjithë popullatën.

Petrit VASILI

MINISTRI



## Pasqyra e lëndës

1	Misioni i Ministrisë .....	4
2	Dokumenta strategjike të Ministrisë.....	5
3	Programet buxhetore të Ministrisë.....	6
4	Përmbledhje e angazhimeve kryesore në 2010.....	7
5	Plani i Monitorimit i Ministrisë .....	11
Aneks 1	Projekt-ligjet për t'u paraqitur.....	12
Aneks 2	Rezultate që lidhen me Integrimin European.....	13
Aneks 3	Investimet publike .....	15
Aneks 4	Projekte të ndihmës së huaj .....	17
Aneks 5	Masat në kuadër të luftës antikorrupsionit.....	18

# **1 Misioni i Ministrisë**

Ministria e Shëndetësisë ka për mision hartimin dhe zbatimin e politikave e strategjive të zhvillimit në sistemin shëndetësor, është përgjegjëse për rregullimin e tij si dhe për koordinimin e të gjithë aktorëve brenda dhe jashtë sistemit shëndetësor. Racionalizimi i shërbimeve shëndetësore, rajonalizimi i tyre, efektiviteti financiar i burimeve në shëndetësi, përcaktimi i standarteve dhe shërbimeve cilësore, edukimi i vazhdueshëm i ofruesve të shërbimeve, monitorimi dhe vlerësimi bazuar në evidenca si dhe edukimi dhe promovimi shëndetësor janë disa nga shtyllat kryesore mbi të cilat do të mbështetet reforma në shëndetësi në 4 vitet e ardhshme. Përmirësimi i performancës së sistemit shëndetësor drejt arritjes së qëllimeve dhe objektivave është një nga mekanizmat kryesor, i cili do të bëjë të mundur realisht shërbim më të mirë për qytetarët si dhe kënaqshmëri më të madhe të qytetarëve ndaj sistemit.

## 2 Dokumenta strategjike të Ministrisë

### Strategjia Kombëtare e shëndetësisë

Dokumenti është diskutuar në Komitetin e Planifikimit Strategjik dhe po punohet për përmirësimin e tij duke përfshirë dhe parashikimin e shpërndarjes së burimeve financiare afatmesme dhe afatgjata mbi bazën e kostimit të politikave. Më pas do të vazhdohet procedura e miratimit në Këshillin e Ministrave.

### Strategjia ndërsektoriale e mbrojtjes së konsumatorit

Bazuar në kuadrin ligjor ekzistues dhe të përmirësuar (Ligji “Për Ushqimin”) dhe në përputhje me kuadrin rregullator të BE-së, veçanërisht Strategjinë e Politikave për Konsumatorët e BE-së (2007-2013), Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorëve, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës dhe Ministria e Shëndetësisë zhvilluan strategji individuale për mbrojtjen e konsumatorit (2007-2013), të cilat më pas u integruan në dokumentin e strategjisë së përbashkët. Në strategjinë e përbashkët janë përpiluar vizioni, prioritetet strategjike, strukturat, buxheti dhe afatet kohore. Ministria e Shëndetësisë ka dhënë kontributin e saj në të tëra fazat e zhvillimit të Strategjisë Ndërsektoriale të Mbrojtjes së Konsumatorit.

### Qëllimet

Politika e këtij sektori është hartuar për të kontribuar në arritjen e qëllimeve të mëposhtme afatgjata:

- Krijimi i një kuadri ligjor të plotë dhe modern, një sistem financimi adekuat, burime njerëzore të afta për t’u përgjigjur nevojave të sistemit shëndetësor dhe një sistem informacioni të plotë në të gjitha nivelet e shërbimit shëndetësor.
- Akses më i mirë për KSHP dhe ofrimi i shërbimeve sipas normave dhe standarteve të përcaktuara nëpërmjet rritjes së autonomisë së QSH.
- Qendra Shëndetësore dhe ambulanca në të tërë qendrat e banuara sipas standardeve të përcaktuara në dokumentin e standardeve të akreditimit të qendrave shëndetësore.
- Mbulimi me ambulanca i 100% të territorit të vendit, deri në vitin 2015.
- Reduktimi i niveli të vdekshmërisë së fëmijeve nën 5 vjeç, në 10/1000 lindje të gjalla deri në 2015 në krahasim me 20/1000 lindje të gjalla për vitin 2001.
- Reduktimi i vdekshmërisë amtare në vitin 2015, me 1/2 nga 2001 (22,7 vdekje për 100 000 lindje të gjalla)
- Edukimi i 90% të popullsisë, mbi principet e kujdesit shëndetësor të gojës dhe përfitimi nga fluorizmi i 90% të grupmoshës 0-6 vjeç, deri në vitin 2015.
- Ofrimi i modeleve bashkëkohore të manaxhimit të spitaleve i mbështetur nga sisteme të zhvilluara informacioni klinik dhe financiar si dhe ngritjen e sistemit të monitorimit i cili do të masë performancën spitalore dhe do të lejojë akreditimin e spitaleve. Fuqizimi dhe optimizimi i shërbimeve ekzistuese.
- Riorganizimi i shërbimit të transfuzionit dhe akreditimi i këtij shërbimi deri në 2010.
- Sigurimi me vakcina dhe imunizimi me vakcina të detyrueshme të mbajtur respektivisht në nivelet 100% dhe mbi 95%. 0 raste me poliomielit dhe fruth. Vetëm raste të rralla dhe sporadike për rubeolën, difterinë dhe tetanozin. Seropozitiviteti i hepatit B tek fëmijët nën 1 vjeç i ulur.
- Ulja çdo vit në masën 5% e numrit të disa infeksioneve me burim ujë si rezultat i survejancës së sëmundjeve infektive dhe monitorimit të ujit të pijshëm.
- Laboratorët e shëndetit publik të fuqizuar totalisht deri në vitin 2015.

- Ulja çdo vit e numrit të disa infeksioneve me burim ujin si rezultat i survejancës së sëmundjeve infektive dhe monitorimit të ujit të pijshëm.
- Laboratorët e shëndetit publik në nivel qendror në nivel bashkohor deri në vitin 2015.

### **3 Programet buxhetore të Ministrisë**

#### **3.1 PLANIFIKIM, MENAXHIM, ADMINISTRIM**

Politika e këtij Programi konsiston në përmirësimin e strukturës funksionale për një menaxhim adekuat të sistemit shëndetësor; Hartimin e dokumentave politike, strategjive dhe planeve kombëtare të zhvillimit të sistemit shëndetësor; Ruajtjen e integritetit të piramidës së shërbimeve shëndetësore duke hartuar "autoritetet shëndetësore rajonale" në nivel qarku; Akreditimin, inspektimin dhe monitorimin e vazhdueshëm të sektorit.

#### **3.2 SHËRBIMET E KUJDESIT PARËSOR**

Politika e këtij Programi konsiston në ofrimin e shërbimeve cilësore të kujdesit shëndetësor parësor të bazuar në komponentet e kujdesit kurativ, parandalues dhe promociional.

#### **3.3 SHËRBIMET E KUJDESIT DYTËSOR**

Politika e këtij Programi konsiston në ofrimin e Kujdesit Spitalor në të gjitha nivelet për një akses më të mirë, cilësi të kënaqshme dhe menaxhim kosto efektiv të këtij shërbimi. Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve me anën e aplikimit të udhëzuesve të praktikës klinike, sistemit të akreditimit, trajnimit të personelit, vlerësimit të teknologjisë mjekësore dhe të performancës me anë të treguesve përkatës.

#### **3.4 SHËNDETI PUBLIK**

Politika në shërbimet e shëndetit publik konsiston në ruajtjen, përmirësimin e shëndetit të popullatës, parandalimin e sëmundjeve infektive dhe kronike nëpërmjet sistemit të survejancës dhe zbatimit të masave dhe programeve përkatëse në fushën e shëndetit publik në bashkëpunim me shërbimin e mjekësisë familjare.



## 4 Përmbledhje e angazhimeve kryesore në 2010

Sipas programeve, Ministria do të ofrojë produktet e mëposhtme në 2010.

### 4.1 PLANIFIKIMI, MENAXHIMI DHE ADMINISTRIMI

Objektivat e politikës

- Trajnimi i profesionistëve të shëndetit
- Pilotimi i standarteve, mbikqyrjes dhe procedurave akredituese në tre spitale
- Zbatimi i sistemit për administrimin e dokumentacionit
- Zbatimi i planit afatshkurtër të përafrimit të legjislacionit.

Produktet që do të ofrohen:

- Dokumenta politike dhe strategjike të hartuar
- Akte ligjore dhe nënligjore të hartuara
- 10 % të nevojave të plotësuara me pajisje mobilimi, zyre dhe kompiuterike;
- 80 % të nevojave të plotësuara me ambiente të rikonstruara;
- 1 Projekt i mbështetur me kontributin e kostos lokale;

### 4.2 SHËRBIMET E KUJDESIT PARËSOR

Objektivat e politikës

- Mbulimi çdo vit me ambulanca i 10% të fshatrave
- Pëmirësimi me 4% i totalit të infrastrukturës të shërbimit stomatologjik publik përfshirë dhe unitet dentare
- Rritja me 20% e aktiviteteve të informimit dhe promovimit shëndetësor sipas kalendarit të promovimit.
- Rritja në masën 10% e kontributit të buxhetit për sigurimin e kontraceptivëve në shërbimet publike të planifikimit familjar.
- Ngritja e sistemit të informacionit për aktivitetin e DRSH, ISHP dhe ASHR dhe furnizimi i të dhënave në Ministrinë e Shëndetësisë

Produktet që do të ofrohen

- 5 600 000 Vizita të kryera nga njësitë e kujdesit shëndetësor parësor;
- 10% Rritja e masës së financimit nga buxheti i shtetit për sigurimet shëndetësore;
- 3 Projekte të reja të bëra; zbatimi për ndërtime të reja dhe rikonstruksione
- 30% e nevojave të plotësuara me pajisje mjekësore;
- 20% e nevojave të plotësuara me ambiente të rikonstruara;
- 3 Projekt i mbështetur me kontributin e TVSH & detyrimin doganor;
- 5 Poliklinika të rehabilituara; ( 2 në Tiranë, Korçë, Gjirokastër, Peshkopi)
- 30 % e nevojave të plotësuara me pajisje mobilimi dhe zyre;

### **4.3 SHËRBIMET E KUJDESIT DYTËSOR**

Objektivat e politikës

- Përmirësim i manaxhimit të burimeve njerëzore dhe financiare në spitalet universitare të Tiranës;
- Plotësimi në masën 30% më shumë i nevojave bazë në shërbimet e shëndetit mendor me shtretër;
- Plotësimi 100% çdo vit me barna dhe 30 % me pajisje mjeksore;
- Trajtimi për hemodializë me të gjithë komponentët i 20% më shumë pacientëve;
- Dyfishim i procedurave diagnostike dhe terapeutike (numri i ndërhyrjeve) në sëmundjet koronare të zemrës;
- Plotësimi i nevojave me gjak dhe produkte të tij me një cilësi dhe siguri më të lartë të mundshme;
- Planifikimi dhe sigurimi i barnave dhe materialeve të mjekimit në përputhje me nevojat më prioritare të spitaleve;
- Përmirësimi i kushteve jetësore në spitalet psikiatrike dhe trajtimi riaftësues terapeutik dhe jo nga ekipe multidisciplinare;
- Ngritja e tre shtëpive mbështetëse me nga 10 shtretër për të sëmurët kronikë në Shkodër;
- Ngritja e sistemit të informatizimit të informacimit shëndetësor.

Produktet që do të ofrohen:

- 260 000 pacientë të trajtuar në spitale;
- 680 pacientë të trajtuar në spitalet psikiatrike;
- Shërbime mbështetëse në spitalet e vendit të siguruara;
- 15% të nevojave të plotësuara me ambiente të rikonstruara;
- 15 projektme të reja të bëra;
- 30 spitale të rehabilituar nga ana fizike;
- 25 % e nevojave të plotësuara me pajisje mjekësore;
- 15 % të nevojave të plotësuara me pajisje mobilimi dhe zyrë;
- 4 Projekte të mbështetura me kontributin e TVSH & detyrimi doganor;
- 2 Spitale të reja: Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza” mjekësia interne, Spitali Kavajë.

### **4.4 SHËNDETI PUBLIK**

Objektivat e politikës

- Përgatitja e listës së indikatorëve të shëndetit mjedisor sipas rekomandimeve të OBSH-së;
- Udhëzuesit e hetimit të shpërthimeve epidemiologjike të përditësuar dhe diseminuar;
- Raportim i sëmundjeve të caktuara i përmirësuar, proporcioni i rretheve që raportojnë në kohë dhe me cilësi të lartë në rritje;
- Rritje e numrit të epidemiologëve, inspektorëve sanitarë dhe profesionistëve të shëndetit publik, të ngritur profesionalisht në fushat përkatëse;
- Fuqizimi i diagnostikës së sëmundjeve infektive;

- Ngritja e qëndrave të trajtimit dhe parandalimit të sjelljeve të rrezikshme në dy rajone të vendit;
- Sugurimi i vaksinave dhe monitorimi i tyre.

Produktet që do të ofrohen

- 240 000 fëmijë të vaksinuar;
- 62 400 Vrojtime të kryera për kontrollin e situatës epidemiologjike;
- 11 Laboratorë të shërbimeve të shëndetit publik të mirëmbajtur;
- 12 Raporte të prodhuara për grup problemesh;
- 15% Testime vullnetare më shumë të kryera për HIV/AIDS;
- 38 Kontrolle mjedisore (ujë, ajër, ushqim, etj);
- 20 Aktivitete promovuese në vit;
- 12% të nevojave të plotësuara me pajisje mjekësore;
- 10% të nevojave të plotësuara me pajisje kompiuterike, elektrike dhe teknologjike;
- 12% të nevojave të plotësuara me ambiente të rikonstruara;

**Tabela Buxheti 2010 sipas programeve dhe llojeve të shpenzimeve, million Lek**

Programet	Pagat dhe kontribute sigurimeve shoqërore 600, 601	Mallra dhe shërbime 602	Subvecionet 603	Të transfert korrente 604, 605	Transferta tjera për buxhetet e familiare dhe individët 606	Shpenzime kapitale 230, 231	Total
Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	150	40,8	0	3	4,3	50,162	<b>248,262</b>
Shërbimet e Kujdesit Parësor	45,7	20,8	0	6 661	0,1	1 325, 128	<b>8 052,728</b>
Shërbimet e Kujdesit Dytësor	448,3	725	0	12 700	1,5	3 940, 848	<b>17 815, 648</b>
Shërbimet e Shëndetit Publik	1 678	585,9	0	774,6	10	160	<b>3 208,5</b>
<b>Total</b>	<b>2 322</b>	<b>1 372,5</b>	<b>0</b>	<b>20 138,6</b>	<b>15,9</b>	<b>5 476,138</b>	<b>29 325, 138</b>

## 5 Plani i Monitorimit i Ministrisë

Identifikoni dhjetë produktet/treguesit më të rëndësishëm që do të monitorojnë arritjet e ministrisë gjatë vitit 2010.

Treguesit	Njësia	Qëllimi
1. Vdekshmëria foshnjore	Vdekje për 1000 lindje të gjalla	Përmirësim i kujdesit prenatal, obstetrikal dhe postnatal
2. Vdekshmëria amtare	Vdekje për 100 000 lindje të gjalla	Përmirësim i cilësisë së shëndetit riprodhues
3. Niveli i mbulesës vaksinale	Përqindje (raporti i të vaksinuarve me popullatën target)	Kontroll i sëmundjeve infektive
4. Numri i vatrave infektive/shpërthime	Nr.	0
5. Përqindja e grave shtatzanë që kërkojnë vizitën e parë gjatë tremujorit të parë	% e popullatës target	>95%
6. Niveli i përdorimit të kontraktivëve modern në moshën riprodhuese	% e popullatës target	>11%
7. Shfrytëzimi i shtratit	Përqindje (raporti i shfrytëzimit në ditë/kohëzgjatja e periudhës)	Përmirësimi i efikasitetit të spitaleve
8. % e sectio cesarea	% (Raporti i numrit të lindjeve me s.c/numri total i lindjeve)	Monitorimi i sigurisë së lindjes
9. Plotësimi i nevojave me gjak/produkte	Përqindje (rapoti i numrit të kërkesave/numrin e kërkesave të plotësuara)	Arritja e vetëmjaftueshmërisë kombëtare
10. Raste të infektuara me agjentë infektivë të transmetueshëm me anë të transfuzionit	Numër	Monitorimi i sigurisë së gjakut

## Aneks 1 Projekt-ligjet për t'u paraqitur

- Projektligji “Për disa ndryshime në ligjin Ligjin Nr. 9323, datë 25.11.2004 “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”
- Projektligji për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr 9106 datë 17.07.2003 “Për shërbimin spitalor në RSH”
- Projektligji “Per Indet dhe qelizat
- Projektligji “Per disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr 8092 datë 21.03.1996 “Për shëndetin mendor”
- Projekt VKM “Për pullën e dyfishtë të kontrollit të barnave”
- Projekt VKM “Për rregullat për parandalimin e transmetimit të HIV-it, në institucionet e edukimit, të riedukimit, institucionet e trajtimit mjekësor, institucionet rezidenciale të përkujdesit social, në burgjet dhe vendet e paraburgimit
- Projektvendim për përcaktimin e llojit, masës së ndihmës shoqërore, si dhe kriteret e procedurat për shpërndarjen e tyre për personat nën 18 vjeç, të infektuar me HIV/AIDS.
- Projekt VKM “Rregullat dhe mënyra e procesit të akreditimit të kujdesit shëndetësor”
- Projekt VKM “Për miratimin e paketës së shërbimeve ndihmëse të shëndetit publik”
- Projekt VKM “Për përbërjen, kriteret e përzgjedhjes së anëtarëve, kompetencat, detyrat dhe mënyra e funksionimit të Këshillit Kombëtar të Shëndetit Publik”
- Projekt VKM “Për ngritjen organizimin dhe funksionimin e Këshillit shkencor të ISHP”
- Projekt VKM “Për zbatimin e Rregullores Ndërkombëtare të Shëndetit”
- Projekt VKM “Për miratimin e rregullores higjieno sanitare”
- Projekt VKM “Për ujrat larëse”
- Projekt VKM “Për punë të sigurtë me burimet e rrezatimit jonizues”
- Projekt VKM “Për transportin e sigurte te materialeve radioaktive
- Projekt VKM “Per statusin, organizimin, strukturen dhe funksionimin e QKKB”
- Projekt VKM “Mbi strukturen dhe funksionimin e Komisionit te Çmimeve te Barnave”

## Aneks 2 Rezultate që lidhen me Integrimin European

- Ne kuader të angazhimeve të ndermarra për zbatimin e MSA-se, do të përafrohohen një sërë iniciativash ligjore (në përputhje dhe me matricën e mesiperme të projektakteve) me direktivat europiane kryesisht në fushën e:
  - Levizjes së lirë të mallrave (barnat dhe produktet kozmetike)
  - Energji dhe mjedisit (cilësi e ujit të pijshëm dhe mbrojtës nga rrezatimet)
  - Shëndetit publik (semundjet ngjitëse, transfuzioni dhe siguria e gjakut, shëndeti mendor)

Përsa i përket aktiviteteve zbatuese të planifikuara për vitin 2010 në zbatim të procesit të integritimit europian janë parashikuar:

- Ngritja dhe fuqizimi i Njesisë së Inxhinierisë Klinike në spitalin rajonal të Kukësit;
- Ngritja e njesisë së farmakovigjilencës;
- Hartimi i planit të aktiviteteve dhe masave për zbatimin e rregullores për ujë të pijshëm;
- Krijimi në Tiranë i tre klubeve të alkoolisteve në trajtim, misioni kryesor i të cilëve është mbështetja psikologjike e abstinenteve alkoolik;
- Ngritja e një njësie alkoolgjike në qytetin e Vlorës e modelit të asaj të QSUT-së;
- Trajnime me studentët e fakultetit të mjekësisë dhe mjekë të shërbimit parësor për të ndihmuar duhanpirësit në lënien e duhanit – 2010;
- Trajnime me studentët e fakultetit të mjekësisë dhe mjekë të shërbimit parësor për të ndihmuar duhanpirësit në lënien e duhanit – 2009;
- Trajnime me mësuesit e shkolleve 9-vjeçare për kontrollin e duhanit (peer educator) – 2009;
- Trajnime me mësuesit e shkolleve 9-vjeçare për kontrollin e duhanit (peer educator) – 2010;
- Fuqizimi i sistemit të mbledhjes së gjakut, përpunimit dhe testimit të gjakut në QKTGJ;
- Krijimi i njesisë së hemovigjilencës në Tiranë;
- Ngritja e qendrës rajonale të bankës së gjakut në Shkodër për mbledhjen, përpunimin dhe shpërndarjen e gjakut dhe produkteve të tij;
- Përmirësimi i survejancës së HIV/AIDS dhe sëmundjeve seksualisht të transmetueshme;
- Përmirësimi i mirëmbajtjes së sistemit ALERT;
- Kryerja e analizës mbi implementimin e Rregullores Ndërkombëtare të Shëndetit (2005) në vendin tonë;
- Kryerja e workshop-it me specialistë dhe punonjës të shëndetësisë mbi zbatimin e legjislacionit shqipëtar të shëndetit publik;
- Analiza e sistemit të survejancës të sëmundjeve infektive dhe lajmërimit të shpejtë në funksion të zbatimit të rregullores ndërkombëtare të shëndetit;
- Mbajtja e mbulësive vaksinore mbi 95% për secilin antigen të Kalendarit tonë kombëtar të Vaksinimit për fëmijet.

### Aneksi 3: Investimet publike(ne leke)

	<b>TOTALI</b>	<b>5,476,138,000</b>	
	<b>PLANIFIKIM-ADMINISTRIM</b>	<b>50,162,000</b>	
	Aparati I MSH	45,162,000	
	TVSH dhe Kosto Lokale -aparati	5,000,000	
	<b>SHERBIMET E KUJDESIT PARESOR(buxheti i shtetit+financim I huaj)</b>	<b>1,325,128,000</b>	
	Buxheti I shtetit	636,038,000	
	TVSH+K.LOKALE PER SH.PARESOR	249,590,000	
	Financimi i Huaj-sh.paresor	439,500,000	
	<b>SHERBIMET E SHENDETIT PUBLIK</b>	<b>160,000,000</b>	
	<b>SHERBIMET E KUJDESIT SPITALOR(fin.brendshem+ fin.huaj)</b>	<b>3,940,848,000</b>	
	Sh.Kujdesit Spitalor -Financim I Brendshem	2,615,210,000	
	Kosto Lokale+TVSH per Sh.Spitalor	590,000,000	
	Financimi I Huaj Sh.Spitalor	735,638,000	

## Aneks 4 Projekte të ndihmës së huaj

Nr	Emertimi i projektit	Grant/ Kredi	Emri i Donatorit	Planifikimi Disbursimeve 2010
1	Projekti per Spitalin e Pergjithshem Kavaje	Kredi	Banka Islamike per Zhvillim	1.484.647,00
	Projekti per Spitalin e Pergjithshem Kavaje	Kredi	Fondi OPEC	2.420.000,00
2	Projekti per Fazen e Dyte te Spitalit te Pergjithshem Durres	Kredi	Banka Islamike per Zhvillim	321.770,89
3	Faza e pare e masterplanit te QSUT	Kredi	Banka e Keshillit te Europes	645.000,00
4	Rehabilitimi i spitalit rajonal Shkoder – faza e trete	Kredi	Banka e Keshillit te Europes	3.000.000,00
5	Projekti HIVAIDS	Grant ALB-506-GO1-H	Fondit Global - GFATM	774.351
6	Projekti Tuberkulozit	Grant ALB- 506-G02-T	Fondit Global - GFATM	139.026
7	Modernizimi sistemit shendetsor		Banka boterore,IDA	3.000.000,00
	Modernizimi sistemit shendetsor	Kredi	Qeveria japoneze	
	Modernizimi sistemit shendetsor	Grant		
8	Kredia Austriake per Sanatoriumin	Kredi	Qeveria Austriake	4.351.115,00
9	Ndertimi i 5 Poliklinikave	Kredi	Kooperacioni Italian	



## Aneks 5 Masat në kuadër të luftës anti korrupsionit

OBJEKTIVAT	MASAT	INSTITUCIONET PERGJEGJESE / BASHKEPUNUES E	AFATI I REALIZIMIT	BURIMET E ZBATIMIT	TREGUESIT MONITORUES
<p><b>BARNAT</b></p> <p>Permiresimi dhe rritja e transparences gjate procedures se miratimit te cmimit te barnave</p>	<p>Projektvendimi “Mbi strukturën dhe funksionimin e Komisionit të Cmimit të barnave”.</p>	<p>Ministria e Shëndetësisë, Drejtoria Farmaceutike MF</p>	<p>e katermujori i dyte</p>	<p>Buxheti i shtetit (30.000 leke)</p>	<p>Projektvendimi i derguar ne Keshillin e Ministrave</p>
	<p>Publikimi i te dhenave krahasuese e permbledhese per te rritur transparencen</p>	<p>Ministria e Shëndetësisë, Drejtoria Farmaceutike MF</p>	<p>e Katermujori i trete</p>	<p>Buxheti i shtetit (8.000 leke)</p>	<p>Broshura e publikuar ne faqen zyrtare te msh</p>
	<p>Projektvendimi “Për pullën e dyfishtë të kontrollit të barnave”. Pulla e dyfishte do ti vendoset vetëm barnave të rimbursueshme nga ISKSH dhe ka si qëllim uljen e abuzimit nga ana e farmacistëve gjatë ekzekutimit të recatave me rimbursim.</p>	<p>Ministria e Shëndetësisë, Drejtoria Farmaceutike MF</p>	<p>e katëemujori i pare</p>	<p>Buxheti i shtetit (30.000 leke)</p>	<p>Projektvendimi i derguar ne Keshillin e Ministrave</p>

OBJEKTIVAT	MASAT	INSTITUCIONET PERGJEGJESE / BASHKEPUNUES E	AFATI I REALIZIMIT	BURIMET E ZBATIMIT	TREGUESIT MONITORUES
Permirësimi i mënyrës së përcaktimit të listave baze(LB) duke përcaktuar kritere dhe procedurë të qarta	Urdhër i Ministrisë të Shëndetësisë për përcaktimin e kritereve dhe procedurave për hartimin e LB	Ministria e Shëndetësisë, Drejtoria Farmaceutike ISKSH	Katërmujori i tretë	Buxheti i shtetit ( 50.000)	Urdhëri i Ministrisë të Shëndetësisë i miratuar
<b>PROKURIMI</b> Rritja e transparencës dhe konkurrencës në procedurat e prokurimit publik	Kryerja e procedurave të hapura të prokurimit duke rritur pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë	Ministria e Shëndetësisë Drejtoria e Prokurimeve autoritet	Gjatë vitit	Buxheti i shtetit	Numri i shtuar i operatorëve ekonomikë që kanë marrë pjesë në tendera.

OBJEKTIVAT	MASAT	INSTITUCIONET PERGJEGJESE / BASHKEPUNUES E	AFATI I REALIZIMIT	BURIMET E ZBATIMIT	TREGUESIT MONITORUES
Rritja e transparencës në planifikimin e nevojave të institucionet shëndetësore	Publikimi i të gjitha procedurave nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimit	kontraktore në institucionet e vartësise Ministria e Shëndetësisë Drejtoria e Prokurimeve autoritet kontraktore në institucionet e vartësise	Gjate vitit	Buxheti i shtetit	Procedurat e prokurimit të publikuara
	Urdher i Ministrit për hartimin e listës së materialeve të konsumit nga institucionet shëndetësore	Ministria e Shëndetësisë Drejtoria e Spitalore Drejtoria e Shëndetit Publik dhe institucionet e vartësise, Shoqatat e pacientëve dhe mjekëve dhe Urdheri i Mjekut	4 muji i trete	Buxheti i shtetit	Lista e materialeve të konsumit e miratuar
	Urdher i Ministrit për afishimin e gjendjes së materialeve të konsumit të cdo institucioni shëndetësor	Ministria e Shëndetësisë Drejtoria e Spitalore Drejtoria e Shëndetit Publik		Buxheti i shtetit	Listat e afishuara në faqen zyrtare të internetit të MSH

OBJEKTIVAT	MASAT	INSTITUCIONET PERGJEGJESE / BASHKEPUNUES E	AFATI I REALIZIMIT	BURIMET E ZBATIMIT	TREGUESIT MONITORUES
		dhe institucionet e vartesisë	4 muhori i trte		
<b>RAPORTI MJEK - PACIENT</b> Rregullimi i ceshtjes se pagesave informale dhe instiutionalizimi i pageses se kosos reale te sherbimeve (perjashtuar ato te urgjences)	Zbatimi i sistemit te referimit te pacienteve ne sherbimin shendetesor sipas Urdherit nr 52 date 12.10. 2009 “Per zbatimin e sistemit te referimit ne sistemin shendetesor” dhe i Udhezimit Nr 558 datë 26.10.2009 “Për rregjistrimin, identifikimin dhe lëvizjen e pacientit brenda institucioneve shëndetësore në zbatim të sistemit të referimit”	Ministria e Shëndetsisë Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor strukturat e vartesisë	Gjate vitit	Buxheti i shtetit	Numri i pacientëve të rregjistruar dhe numri pacientëve të referuar
	Projektvendimi “Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor ”,	Ministria e Shëndetsisë Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shendetesor	Katerruhori i pare	Buxheti i shtetit ( 50.000)	Projektvendimi i derguar ne KM
	Hartimi i udhezuesve te praktikës mjekësore dhe protokollet e mjekimit ne	Ministria e Shëndetsisë Drejtoria Spitalore	Katerruhori i trete	Donatore	Udhezuesit e praktikës mjekësore te miratuar Protokollet e miratuara

OBJEKTIVAT	MASAT	INSTITUCIONET PERGJEGJESE / BASHKEPUNUES E	AFATI I REALIZIMIT	BURIMET E ZBATIMIT	TREGUESIT MONITORUES
<p>Transparenca ne rradhen e dhenies se sherbimeve ne cdo mjedis shendetesor</p> <p>Ngritja e nje sistemi te integruar te informacionit shendetesor.</p>	<p>funksion te llogaritjes se kostove te sherbimeve.</p> <p>Publikimi i te drejtave dhe sherbimeve qe u takojne pacienteve dhe i sherbimeve qe ofrojne institucionet shendetesore.</p> <p>Krijimi i një sistemi DataWarehouse për Institutin e Shëndetit Publik.</p> <p>Informatizimi i Sistemit të Informacionit Spitalor</p> <p>Përgatitja e kartës së shëndetit.</p> <p>Plani për informatizimin total të sistemit shëndetësor</p>	<p>Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shendetesor</p> <p>Ministria e Shëndetsisë Institucionet shendetesore te varesise</p> <p>Ministria e Shëndetsisë ISKSH Institucionet shendetesore te varesise</p>	<p>Katerrmuji i trete</p> <p>Katerrmuji i trete</p>	<p>Buxheti i shtetit Donatore (kooperacioni Italian 30 000 Euro)</p> <p>Buxheti i shtetit 112 milion leke , Donatore (BB) 4.9 milion dollare</p>	<p>Numri i posterave te shperndare ne institucionet shendetesore</p> <p>Sistemi i ngritur</p> <p>Sistemi i informacionit i vendosur ne sherbimin spitalor</p> <p>Krijimi i infrastruktures se nevojshem per te perdoruir i IT kombetare si karte shendeti</p> <p>Plani i perfunduar</p>

OBJEKTIVAT	MASAT	INSTITUCIONET PERGJEGJESE / BASHKEPUNUES E	AFATI I REALIZIMIT	BURIMET E ZBATIMIT	TREGUESIT MONITORUES
<p><b>POLITIKA TE BURIMEVE NJEREZORE</b></p> <p>Permiresimi i sistemit te pagesave te personelit mjekesor</p>	<p>Ndryshimi i Ligjit Nr9106 datë 17.07.2003 “Për shërbimin spitalor në RSH” do ti kushtojë një vëmendje të vecantë rritjes së autonomisë së spitaleve organizimit të tyre dhe do te synojne vecanerisht reduktimin e korrupsionit ne te 3 tipet e marredhenieve qe vendosen ne kete sektor (personel mjekësor-pacient, institucion-pagues dhe institucion- furnizues).</p>	<p>Ministria e Shëndetësisë dhe ISKSH</p>	<p>katermujori i pare</p>	<p>100 000 leke</p>	<p>Projektligji i derguar ne KM</p>

